

VENDIM
Nr. 556, datë 18.6.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 169, DATË 25.2.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT NË INSTITUCIONET E
ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2015”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të vendimit nr. 169, datë 25.2.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“b) Për kategorinë e mesme drejtuese 100.

c) Për kategorinë e ulët drejtuese 280”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama